

**Shtëpia Botuese SHBLSH e RE**  
**Planet mësimore për vitin shkollor 2011- 2012 në lëndën Aftësim Teknologjik**  
**(klasa 5, 6, 7).**

**Aftësim teknologjik 5**

**Ndërtimi i librit "Aftësim teknologjik 5"**

Libri ka katër linja kryesore:

**1.Njeriu dhe shoqëria në teknologji** (10 orë: 6 orë njohuri të reja, 4 orë veprimtari praktike )

**2.Teknologjia e informacionit dhe komunikimi** (8 orë: 4 orë njohuri të reja, 4orë veprimtari praktike)

**3.Teknologjia e materialeve dhe proceseve** (8 orë: 4 orë njohuri të reja, 4 orë veprimtari praktike)

**4.Strukturat, mekanizmat, forca dhe energjia** (6 orë: 3 orë njohuri të reja, 1 orë veprimtari praktike, 2 orë eskursion mësimor)

Pas zhvillimit të 4 orëve mësimore të linjës 4, realizohen **2 orë eskursion mësimor**, që mësuesi/ ja e organizon në një kantjer ndërtimi që ndodhet pranë shkollës. Objektivi kryesor është që: nxënësit të njohin nga afër proceset e përgatitjes së tullave. Në program janë në dispozicion të mësuesit **3 orë të lira**. Në orët e lira është menduar të organizohen veprimtari në shkollë, për krijimin apo pasurimin e "**Këndit të Teknologjisë**", ku vendosen punimet më të mira të realizuara në orët e punëve praktike. Në këtë veprimtari mund të ftohen prindër, mësues dhe nxënës të tjerë të shkollës.

**Përmbajtja e lëndës "Aftësim teknologjik 5"**

Orë gjithsej	35 orë
Orë njohuri të reja (T)	17 orë
Orë punë praktike ( PP)	13 orë
Orë të lira	3 orë
Orë eskursion (E)	2 orë

## Shtëpia Botuese SHBLSH E RE

### Plani mësimor: Aftësimi teknologjik 5 (klasa e pestë)

Plani mësimor është i bazuar në kurikulën e miratuar nga MASH.

Kurikula është zbatuar plotësisht në librin e hartuar, i cili në të gjithë përmbajtjen e tij në çdo orë përputhet me të.

Libri ka objektivat kryesorë dhe specifik.

<b>Linja 1</b> <b>Njeriu dhe shoqëria</b> <b>në teknologji (10orë)</b>		<b>Objektiva të përgjithshëm</b>
		<p>Të tregojë lidhjen e njeriut me mjedisin ku jeton dhe ndikimin e tij për ta mbrojtur atë.</p> <p>Të përgatisë filtrin që përdoret për trajtimin mekanik të ujrave të zeza familjare.</p> <p>Të dallojë si ndikon zhvillimi i teknologjisë në rritjen e shumëllojshmërisë të ushqimeve.</p> <p>Të vlerësojë rolin e drithrave, qumështit dhe nënprodukteve të tij në dietën ditore.</p> <p>Të marrë pjesë aktive në veprimtaritë praktike që zhvillohen në klasë.</p> <p>Të plotësojë anketa të ndryshme për mënyrën e të ushqyerit.</p>
	<b>Titulli i mësimit</b>	<b>Objektiva për çdo orë mësimi</b> <b>Nxënësi/ja duhet:</b>
1	1.1 Njeriu në shoqërinë në zhvillim.	<p>Të dallojë hapat kryesorë të zhvillimit të shoqërisë njerëzore.</p> <p>Të argumentojë se si mund të ndikojë për mirë në mjedisin e qytetit apo të fshatit ku banon.</p>
2	1.2 Uji në natyrë.	<p>Të dallojë ujin si një pasuri e njerëzimit.</p> <p>Të vlerësojë masat që merren për kursimin e ujit.</p>
3	1.3 Veprimtari praktike.	<p>Të shpjegojë si formohen dhe ku shkarkohen ujrat e ndotura.</p> <p>Të përgatisë filtrin për pastrimin e ujit të ndotur.</p> <p>Të ndjekë etapat e ndryshme të procesit të filtrimit.</p>
4	1.4 Prodhimi i	Të dallojë lëndët e para kryesore për

	sapunit.	prodhimin e sapunit. Të shpjegojë se përdorimi i sapunit ndikon në shëndetin e njeriut.
5	1.5Klasifikimi i ushqimeve	Të dallojë që njeriu ka nevojë për ushqime të ndryshme. Të njohë përbërësit kryesorë të ushqimeve, si: yndyrnat, proteinat, karbohidratet, vitaminat, kripërat minerale. Të vlerësojë ndikimin e teknologjisë në rritjen e shumëllojshmërisë të ushqimeve.
6	1.6 Prodhimi i bukës.	Të dallojë bukën si ushqimin më popullor në shumë vende të botës. Të njohë lëndët e para për prodhimin e bukës. Të shpjegojë skemën teknologjike të prodhimit të bukës.
7	1.7 Veprimtari praktike.	Të përgatisë sanduiçë me mbushje të ndryshme. Të ndjekë një rradhë të caktuar veprimesh për përgatitjen e tij.
8	1.8 Qumështi dhe nën produktet.	Të dallojë qumështin si ushqim i cili përmban një sasi të madhe substancash ushqyese. Të vlerësojë domosdoshmërinë e përpunimit termik të qumështit. Të njohë nënproduktet e qumështit.
9	1.9 Veprimtari praktike.	Të përgatisë me trekëndësha kartoni piramidën e të ushqyerit. Të plotësojë anketën për mënyrën e të ushqyerit.
10	1.10Veprimtari praktike.	Të dallojë, se një drekë apo një darkë e shtruar dhe e shërbyer bukur, kërkon një kujdes dhe planifikim të gjithë rradhës së punëve.
<b>Linja 2. Teknologjia e informacionit dhe komunikimi (8 orë)</b>		<b>Objektiva të përgjithshëm</b>
		Të dallojë si ka ndikuar teknologjia në zhvillimin e komunikimit ndërmjet njerëzve në shekuj. Të përshkruajë si ka ndryshuar teknologjia

		<p>në kohë të ndryshme të qytetërimit.</p> <p>Të marrë pjesë aktive në veprimtaritë e shumëllojshme të zhvilluara në klasë (matje të ndryshme me mjete , vizatime të planimetrive të mjediseve të brendshme të shtëpisë, klasës etj).</p> <p>Të njohë pjesët kryesore të kompjuterit dhe të praktikohet në përdorimin e tij.</p>
	<b>Titulli i mësimit</b>	<b>Objektiva për çdo orë mësimi</b> <b>Nxënësi/ja duhet:</b>
1	2.1 Teknologjia dhe qytetërimi.	<p>Të dallojë si ka ndikuar teknologjia në zhvillimin e komunikimit ndërmjet njerëzve në shekuj.</p> <p>Të njohë epokat e mëdha të qytetërimeve.</p>
2	2.2 Teknologjia dhe qytetërimi.	<p>Të dallojë shkrimin ideografik dhe shkrimin alfabetik.</p> <p>Të njohë disa nga zbulimet kryesore që ndikuan në shoqërinë njerëzore në qytetërimin IV, V.</p>
3	2.3 Prodhimet e objekteve, format, materialet.	<p>Të identifikojë materialet kryesore që përdoren në teknologji.</p> <p>Të dallojë materialet e thjeshta dhe ato të përbëra.</p>
4	2.4 Mjetet dhe aparatet matëse	<p>Të dallojë rëndësinë e pajisjeve matëse.</p> <p>Të përshkruajë një pajisje matëse.</p> <p>Të kryejë matje të ndryshme.</p>
5	2.5 Skicime, vizatime, grafikë.	<p>Të shpjegojë se si duhet vepruar para se të ndërtohet një objekt.</p> <p>Të njohë lloje të ndryshme vizatimesh.</p> <p>Të vizatojë planimetrinë e klasës ose të dhomës së tij.</p>
6	2.6 Telefoni, radioja dhe alfabeti Mors	<p>Të njohë telefonin si mjet komunikimi.</p> <p>Të dallojë se zbulimi i radios ka patur një rëndësi të madhe për njerëzimin.</p> <p>Të marrë pjesë në veprimtarinë praktike.</p>
7	2.7 Televizori. Veprimtari praktike.	<p>Të dallojë rëndësinë e televizorit si mjet shumë i rëndësishëm komunikimi.</p> <p>Të shpjegojë si ka ndikuar zhvillimi i teknologjisë në përmirësimin e transmetimit, zërit, figurës etj.</p>
8	2.8 Makinat llogaritëse, kompjuteri,	<p>Të njohë mjetet e para me të cilat njeriu ka mundur të llogarisë.</p> <p>Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të</p>

	informatika.	kompjuterit
<b>Linja 3. Teknologjia e materialeve dhe proceseve. (8orë)</b>		<b>Objektiva të përgjithshëm</b>
		Të klasifikojë materialet teknologjike sipas grupeve kryesore. Të përshkruajë vetitë kryesore të materialeve teknologjike. Të kryejë punime dhe riparime të objekteve të ndryshme porcelani, druri etj. Të marrë pjesë në veprimtari të ndryshme.
	<b>Titulli i mësimit</b>	<b>Objektiva për çdo orë mësimi Nxënësi/ja duhet:</b>
1	3.1 Materialet-lënda.	Të dallojë skemën e materialeve. Të materialet e thjeshta dhe materialet e përbëra.
2	3.2. Materialet plastike. Përdorimet.	Të dallojë rëndësinë e përdorimit të materialeve plastike. Të njohë lëndët e para për prodhimin e lëndëve plastike.
3	3.3Qelqi dhe qeramika. Përdorimet. Veprimtari praktike.	Të dallojë rëndësinë e e qeramikave në ndërtim, enë kuzhine, objekte zbukurimi. Të njohë vetitë kryesore të qeramikës. Të kryejë riparime dhe punime të ndryshme me plastelinë dhe zbukurime vazosh.
4	3.4 Druri dhe përdorimi i tij. Veprimtari praktike.	Të dallojë drurin si një nga materialet më të vjetra të përdorura nga njeriu. Të njohë vetitë kryesore të drurit. Të dallojë vegla të ndryshme, punime dhe riparime me dru, kashtë etj.
5	3.5 Letra dhe përdorimet e saj.Veprimtari praktike.	Të vlerësojë vetitë e letrës që e bëjnë material të përdorshëm për informacione të ndryshme. Të dallojë lloje të ndryshme letre. Të përgatisë korniza të ngjyrosura, maska etj. në orët e veprimtarisë praktike.
6	3.6.Tekstilet. Përdorimet.Veprimtari praktike.	Të përshkruajë vetitë e tekstileve. Të dallojë llojet e tekstileve. Të praktikohet të bëjë veshje kukullash, mbajtëse gjilpërash etj. në veprimtari praktike.
7	3.7 Metalet.	Të dallojë vetitë që i bëjnë metalet të

	Përdorimet.	rëndësishme në përdorimin e tyre. Të shpjegojë si ndryshojnë vetitë nën ndikimin e kushteve atmosferike.
8	3.8 Materialet dhe mbetjet e tyre. Veprimtari praktike.	Të marrin pjesë aktive në grumbullimin e mbeturinave
<b>Linja 4. Strukturat, mekanizmat, forcat dhe energjia. (4 orë)</b>		<b>Objektiva të përgjithshëm</b>
		Të dallojë struktura të thjeshta dhe elementet që i bëjnë ato të qëndrueshme. Të shpjegojë si punon rrota dhe boshti si makinë e thjeshtë, duke marrë pjesë aktive në veprimtarinë e zhvilluar në klasë. Të përgatisë llaç me mënyra të thjeshta duke përdorur materialet e duhura të ndërtimit.
	<b>Titulli i mësimit</b>	<b>Objektiva për çdo orë mësimi Nxënësi/ja duhet:</b>
1	4.1 Materialet e ndërtimit	Të dallojë materialet që përdoren në ndërtim. Të njohë vetitë e materialeve të ndërtimit. Të marrë pjesë aktive në përgatitjen e një tulle me mënyra të thjeshta.
2	4.2 Materiale dhe mjete pune që përdoren në ndërtim.	Të dallojë mjete të thjeshta pune që përdoren në ndërtim. Të vlerësojë rëndësinë e rradhës të punës në përgatitjen e llaçit.
3	4.3. Mjete dhe vegla pune të thjeshta.	Të dallojë se çdo mjet që përdor njeriu për ta bërë punën më të thjeshtë quhet makinë e thjeshtë. Të dallojë lloje të ndryshme makina të thjeshta.
4	4.4 Rrota dhe boshti. Veprimtari praktike.	Të dallojë se si punon rrota dhe boshti si makinë e thjeshtë. Të përgatisë me mjete të thjeshta makina të thjeshta.

Në këtë plan mësimesor janë të planifikuara 3 orë të lira dhe 2 orë ekskursion mësimesor.

## Aftësim teknologjik 6

### Ndërtimi i librit “Aftësimi teknologjik6”

Libri ka katër linja kryesore:

- 1. Teknologjia e materialeve dhe proceseve** (14 orë: 6 orë njohuri të reja, 8 orë veprimtari praktike)
- 2. Strukturat, mekanizmat, forca dhe energjia** (10 orë: 7 orë njohuri të reja, 3 orë veprimtari praktike)
- 3. Teknologjia e informacionit dhe komunikimi** (4 orë: 2orë njohuri të reja, 2 orë veprimtari praktike)
- 4.Njeriu dhe shoqëria në teknologji** (4 orë: 2 orë njohuri të reja, 2 orë eskursion mësimor)

Në linjën 4 realizohen **2 orë eskursion mësimor**, që mësuesi/ ja e organizon në zonën industriale pranë komunitetit ku jetojnë. Në program janë në dispozicion të mësuesit **3 orë të lira**. Në orët e lira është menduar të organizohen veprimtari në shkollë, për krijimin apo pasurimin e “**Këndit të Teknologjisë**”, ku vendosen punimet më të mira të realizuara në orët e punëve praktike. Në këtë veprimtari mund të ftohen prindër, mësues dhe nxënës të tjerë të shkollës.

### Përmbajtja e lëndës Aftësim teknologjik 6

Orë gjithsej	35 orë
Orë njohuri të reja (T)	17 orë
Orë veprimtari praktike (VP)	13 orë
Orë të lira	3 orë
Orë eskursion (E)	2 orë

## Shtëpia Botuese SHBLSH E RE

### Plani mësimor: Aftësimi teknologjik 6 (klasa e gjashtë)

Plani mësimor është i bazuar në kurikulën e miratuar nga MASH.

Kurikula është zbatuar plotësisht në librin e hartuar, i cili në të gjithë përmbajtjen e tij në çdo orë përputhet me të.

Libri ka objektivat kryesorë dhe specifik.

<b>Linja 1</b> <b>Teknologjia e materialeve dhe e proceseve</b> <b>(14 orë)</b>		<b>Objektiva të përgjithshëm</b>
		Të klasifikojë materialet sipas grupeve kryesore të tyre. Të kryejë eksperimente për të përcaktuar vetitë e materialeve. Të aftësohet në përdorimin e mjeteve të dorës. Të ngjyrosë rroba të ndryshme me bojra natyrore. Të përgatisë letër me materiale të ndryshme.
	<b>Titulli i mësimit</b>	<b>Objektiva për çdo orë mësimi</b> <b>Nxënësi/ja duhet:</b>
1, 2	1.1 Materialet rreth nesh. (2 orë)	Të dallojë objekte të ndryshme që e rrethojnë. Të rendisë materialet që përbëjnë këto objekte.
3, 4	1.2 Metalet. Veprimtari praktike (2 orë)	Të përshkruajë vetitë e metaleve. Të tregojë përdorimet e metaleve. Të kryejë eksperimente për të vëzhguar si ndryshojnë metalet në ndikimin e lagështirës.
5	1.3 Materialet plastike.	Të dallojë vetitë kryesore të plastikës. Të njohë lëndët e para të materialeve plastike. Të dallojë si ndryshojnë vetitë e plastikës me ndryshimin e temperaturës.
6	1.4 Qelqi dhe qeramika.	Të rendisë përbërjet, vetitë e qelqit dhe qeramikës. Të përshkruajë llojet e qelqit dhe qeramikës.
7,8	1.5 Druri dhe nënproduktet e tij. Veprimtari praktike.	Të dallojë vetitë kryesore që e bëjnë atë lëndë të parë të rëndësishme. Të shpjegojë si ndikon djegja e drurit në



	(2 orë)	mjedisin rrethues. Të ndërtojnë kuti të përmasave të ndryshme.
9,10	1.6 Tekstili.Veprimtari praktike (2 orë).	Të dallojë vetitë e tekstileve. Të njohë lloje të ndryshme tekstiles. Të ngjyrosë rroba të ndryshme me bojëra natyrore.
11, 12	1.7 Letra dhe prodhimi i saj. Veprimtari praktike. (2 orë).	Të përshkruajë vetitë e letrës. Të dallojë letrën nga kartoni. Të bëjnë vetë letër me mjete të thjeshta.
13, 14	1.8 Ripërdorimi dhe riciklimi (2 orë).	Të dallojë plehrat shtëpiake, mbeturinat, lëndët e vjetra dhe plehrat e rrugëve. Të vlerësojë procesin e riciklimit. Të marrë pjesë aktive në ndarjen e mbeturinave.
<b>Linja 2. Strukturat, mekanizmat, forcat dhe energja (10orë)</b>		<b>Objektiva të përgjithshëm</b>
		Të krahasojë trupat elastikë me trupat plastikë. Të kryejë eksperimente për të provuar shndërrimet e energjisë nga një formë në formën tjetër. Të ndërtojë modele të makinave të thjeshta me konstruksione (lodra) të ndryshme. Të përgatisë modele të komandimit të llambave me pozicione të ndryshme (me një çelës të thjeshtë, me dy çelsa).
	<b>Titulli i mësimit</b>	<b>Objektiva për çdo orë mësimi Nxënësi/ja duhet:</b>
1	2.1Strukturat. Qëndrueshmëria, tipat e strukturave. Demonstrime praktike.	Të dallojë trupat elastikë nga trupat plastikë. Të përshkruajë dukuritë e shtypjes, tërheqjes, përkuljes, këputjes, përdredhjes.
2	2.2 Energjia. Burimet e energjisë.	Të njohë burime të ndryshme të energjisë. Të dallojë burime të ndryshme të energjisë që shkaktojnë ndotjen e mjedisit.
3	2.3 Format e energjisë dhe ruajtja e saj.	Të shpjegojë si e siguron njeriu energjinë për të punuar. Të tregojë mënyra të shndërrimit të energjisë.

4, 5	2.4 Veprimtari praktike. (2 orë)	Të zhvillojë eksperimente ku vrojtohen shndërrimet e energjisë.
6	2.5 Mekanizma të thjeshta.	Të dallojë mekanizma që kryejnë lëvizje drejtvizore dhe të tjera për lëvizjen rrotulluese.
7	2.6 Makina të thjeshta.	Të dallojë elementë të përbashkët të levave. Të përshkruajë levat e llojeve të ndryshme.
8	2.7 Makina të thjeshta.	Të dallojë llojet e rrotullave. Të ndërtojë modele të thjeshta të rrotullave.
9	2.8 Qarku i rrymës elektrike.	Të shpjegojë rrugën që ndjek rryma elektrike nga vendi ku prodhohet deri te përdoruesi. Të dallojë elementet që formojnë qarkun elektrik.
10	2.9 Veprimtari praktike.	Të ushtrohen të ndërtojnë një qark elektrik të thjeshtë.
<b>Linja 3. Teknologjia e informacionit dhe komunikimit (4orë)</b>		<b>Objektiva të përgjithshëm</b>
		Të përshkruajë mënyra të ndryshme komunikimi. Të kryejë matje të ndryshme me vizore, raportor etj. Të respektojë rregullat gjatë matjeve të ndryshme. Të rendisë karakteristikat e aparateve matëse.
	<b>Titulli i mësimit</b>	<b>Objektiva për çdo orë mësimi Nxënësi/ja duhet:</b>
1	3.1 Vendi i punës nga mund të informohesh.	Të dallojë pjesët kryesore të një posti pune informatik Të respektojë rregullat gjatë punës në kompjuter
2	3.2 Llojet e kontrolleve.	Të kryejë matje të ndryshme me vizore, raportor Të tregojë ndryshimin e matjes së një këndi me raportor dhe vizore
3	3.3 Veprimtari praktike	Të respektojë rregullat e matjeve
4	3.4 Veprimtari praktike.	Të respektojë rregullat e matjeve me

		raportor
<b>Linja 4. Njeriu dhe shoqëria në teknologji (4orë)</b>		<b>Objektiva të përgjithshëm</b>
		Të vrojtojë banesat dhe mjedisin në komunitetin pranë shkollës së tyre. Të nxjerrë përfundime për gjendjen e banesave, rrugëve, sinjalizimeve etj. Të diskutojë për mundësinë e zvogëlimit të mbetjeve gjatë proceseve të ndryshme teknologjike.
	<b>Titulli i mësimit</b>	<b>Objektiva për çdo orë mësimi Nxënësi/ja duhet:</b>
1	4.1 Mjedisi fizik e shoqëror i vendbanimit.	Të dallojë mjedisin fizik e shoqëror të vendbanimit. Të shpjegojë shkaqet kryesore të ndotjeve.
2	4.2 Transporti.	Të shpjegojë rëndësinë e zbulimit të rrotës në teknologjinë e transportit Të dallojë rolin e aksit dhe të kuzhinetave.
3, 4	4.3, 4.4 Veprimtari praktike. Eskursion mësimit.	Të marrë pjesë aktive në eskursionin e organizuar, të vrojtojë dhe të diskutojë për probleme të ndryshme.

Në këtë plan mësimit janë të planifikuara 3 orë të lira dhe 2 orë eskursion mësimit.

## Aftësim teknologjik 7

### Ndërtimi i librit “Aftësimi teknologjik 7”

Libri ka katër linja kryesore:

- 1.Njeriu dhe shoqëria në teknologji** (10 orë: 6 orë njohuri të reja, 4 orë punë praktike)
- 2.Teknologjia e materialeve dhe proceseve** (6 orë:3 orë njohuri të reja, 3 orë punë praktike)
- 3.Strukturat, mekanizmat, forca dhe energjia** (8 orë: 4 orë njohuri të reja, 4 orë punë praktike)
- 4.Teknologjia e informacionit dhe komunikimi** (4 orë: 2 orë njohuri të reja, 2 orë punë praktike)

Pas zhvillimit të linjës 1, realizohen **2 orë eskursion mësimor**, që mësuesi/ ja e organizon në një qëndër tregëtare. Objektivi kryesor është që: nxënësit të njohin nga afër skemën e shitjes nga prodhuesi te konsumatori dhe të dallojnë rolin që luan reklama në shitjen e produkteve.

Në program janë në dispozicion të mësuesit **3 orë të lira**. Në orët e lira është menduar të organizohen veprimtari në shkollë, për krijimin apo pasurimin e “**Këndit të Teknologjisë**”, ku vendosen punimet më të mira të realizuara në orët e punëve praktike. Në këtë veprimtari mund të ftohen prindër, mësues dhe nxënës të tjerë të shkollës.

### Përmbajtja e lëndës Aftësim teknologjik 7

Orë gjithsej	35 orë
Orë njohuri të reja (T)	16 orë
Orë punë praktike ( PP)	14 orë
Orë të lira	3 orë
Orë eskursion (E)	2 orë

## Shtëpia Botuese SHBLSH E RE

### Plani mësimor: Aftësimi teknologjik 7 (klasa e shtatë)

Plani mësimor është i bazuar në kurikulën e miratuar nga MASH.

Kurikula është zbatuar plotësisht në librin e hartuar, i cili në të gjithë përmbajtjen e tij në çdo orë përputhet me të.

Libri ka objektiva kryesorë dhe specifik.

<b>Linja 1. Njeriu dhe shoqëria në teknologji (14 orë)</b>		<b>Objektiva të përgjithshëm</b>
		<p>Të përshkruajë rolin e njeriut në shnërrimin e mjedisit nëpërmjet teknologjive bashkëkohore në dobi të tij.</p> <p>Të llogarisë humbjet e nxehtësisë në mjedisin rrethues të shpjegojë efektin e ngjyrës në veshje, ushqim dhe mobilimin e banesave.</p> <p>Të plotësojë në klasë tabelën "kujdesi në rrugë".</p> <p>Të shpjegojë me shembuj pse prodhuesit duhet të krijojnë konkurrencë midis shpërndarësve.</p>
	<b>Titulli i mësimit</b>	<b>Objektiva për çdo orë mësimi</b> <b>Nxënësi/ja duhet:</b>
1	1.1 Mjedisi fizik dhe shoqëror i vendbanimit. Llojet e banesave.	Të dallojë lloje të ndryshme banesash. Të kuptojë rolin e llojit të materialit që përdoret për ndërtimin e banesave.
2	1.2 Punë praktike.	Të dallojë hartën planimtriqe, planimetrinë, shkallën e zvogëlimit. Të marrë pjesë aktive në ndërtimin e modeleve të ndryshme të banesave.
3	1.3 Mobilimi i banesave. Probleme teknologjike.	Të dallojë si planifikohet mobilimi i banesave. Të shpjegojë si përshtaten zgjedhjet e dhomave me sipërfaqet e tyre.
4	1.4 Punë praktike. Probleme teknologjike në banesa	Të dallojë pse humbet nxehtësia në mjediset e banesave. Të kryejë matje të temperaturës në murin e shtëpisë ose të klasës, pas ngrohësin, pa ngrohës dhe të krahasojë rezultatet.
5	1.5 Ushqimi dhe rëndësia e tij. Përpunimi i ushqimeve	Të dallojë pse gatuajnë njerëzit. Të dallojë që njeriu ka nevojë për ushqime të ndryshme.

	dhe ndryshimi i tyre.	
6	1.6 Punë praktike. Përgatitja e hamburgerit.	Të dallojë origjinën e hamburgerit si një ushqim i preferuar. Të përgatisë hamburger të llojeve të ndryshme.
7	1.7 Veshja dhe kujdesi estetik.	Të njohë si visheshin njerëzit në lashtësi. Të dallojë fazat kryesore të skemës teknologjike të prodhimit të pëlhurës.
8	1.8 Punë praktike. Veshjet, kujdesi për mirëmbajtjen e tyre.	Të dallojë mënyrat kryesore të ruajtjes së rrobave. Të kryejë matje për veshje të ndryshme. Të realizojë katalog me veshje sipas stinëve të ndryshme.
9	1.9 Mjetet e transportit.	Të vlerësojë se shpikja e rrotës përbën revolucion në transport.
10	1.10 Punë praktike. Sinjalizimi rrugor në mjedisin urban.	Të dallojë tabelat e qarkullimit.
11	1.11 Produktet teknologjike. Tregtimi dhe respekti për mjedisin.	Të dallojë këmbimin mall- mall dhe blerjen në dyqan. Të njohë përparësitë e këmbim- blerjes me reklamat, me internet etj.
12	1.12 Zgjedhja e produkteve në treg.	Të dallojë lloje të ndryshme të produkteve në treg. Të tregojë përse sot kërkohen shitjet me korrespondencë, kurse disa pëlqejnë qendrat tregtare.
13	1.13 Llojet e qendrave tregtare.	Të kuptojë organizimin e blerjes të produkteve gjatë javës në familje. Të dallojë lloje të ndryshme qendrash tregtare.
14	1.14 Punë praktike. Produkte të teknologjive të ndryshme.	Të dallojë skemën e shitjes nga prodhuesi te konsumatori. Të vlerësojë ndikimin e reklamës në shitjen e produkteve.
<b>Linja 2.</b> <b>Teknologjia e materialeve dhe proceseve</b> <b>(6 orë)</b>		<b>Objektiva të përgjithshëm</b>
		Të hartojë skemën e materialeve që na rrethojnë. Të rendisë vetitë kryesore të materialeve. Të dallojë e dorës, instrumentet elektrik dhe të aftësohet në përdorimin e tyre. Të ndërtojë një instrument të thjeshtë muzikor

		dhe të përcaktojë tingujt që nxjerrin në varësi të llojit të materialit që përdoret.
	<b>Titulli i mësimit</b>	<b>Objektiva për çdo orë mësimi</b> <b>Nxënësi/ja duhet:</b>
1	2.1 Materialet, burimet, teknika e përpunimit.	Të dallojë grupet kryesore të materialeve. Të shpjegojë skemën teknologjike të prodhimit të qelqit.
2	2.2 Materialet e përbëra.	Të dallojë materialet e përbëra nga materialet e thjeshta. Të shpjegojë rëndësinë njohjes së vetive të materialeve.
3	2.3 Materialet plastike, gomat, materialet qeramike.	Të shpjegojë rëndësinë e materialeve plastike. Të dallojë prodhimin e qeramikës dhe porcelanit.
4, 5, 6	2.4, 5, 6 Punë praktike.	Të njohë mjetet e dorës dhe instrumente elektrike të ndryshme. Të njohë ndërthurjen e materialeve të ndryshme në zbatime praktike. Të ndërtojë një instrument të thjeshtë muzikor.
<b>Linja 3.</b> <b>Strukturat,</b> <b>mekanizmat,</b> <b>forca dhe</b> <b>energja (8orë)</b>		<b>Objektiva të përgjithshëm</b>
		Të rendisë elementët që e bëjnë një strukturë të qëndrueshme. Të ndërtojë strukturë me karton dhe të organizojë konkurs midis grupe nxënësish. Të krijojë një poster me skema që paraqesin shndërrime të energjisë. Të ndërtojë modelin për studimin e levës. Të ndërtojë qark elektrik me element të parapërgatitur.
	<b>Titulli i mësimit</b>	<b>Objektiva për çdo orë mësimi</b> <b>Nxënësi/ja duhet:</b>
1	3.1 Strukturat.	Të dallojë formën dhe strukturën e disa objekteve me qëndrueshmëri të lartë. Të përshkruajë forma strukturore të ndërtesave karakteristike.
2	3.2. Punë praktike.	Të ndërtojë struktura të qëndrueshme. Të dallojë elementët kryesorë të strukturave.
3	3.3 Burimet e energjisë.	Të njohë lloje të ndryshme të energjisë. Të dallojë përparësitë e energjisë diellore dhe

		energjisë të erës.
4	3.4 Punë praktike.	Të përgatisë poster me skema që paraqesin shndërrimet e energjive në forma të ndryshme.
5	3.5 Makinat e thjeshta.	Të dijë të grupjë lloje të ndryshme makinash. Të dallojë elementët kryesorë të levës. Të njohë funksionin e rrotullës dhe rrafshit të pjerrët.
6	3.6 Punë praktike.	Të ndërtojë një levë me elementët përkatës. Të kryejë prova me levën e ndërtuar.
7	3.7 Makinat e thjeshta. Rrota dhe boshti.	Të njohë sistemin rrotë- bosht që përdoret për ndërtimin e objekteve lëvizëse, si: karrocë, biçikletë, makinë. Të dallojë përparësitë që sjell sistemi rrotë-bosht.
8	3.8 Punë praktike.	Të ndërtojë qarkun elektrik me element të gatshëm.
<b>Linja 4. Teknologjia e informacionit dhe komunikimi (4orë)</b>		<b>Objektiva të përgjithshëm</b>
		Të shpjegojë ndryshimet që ka sjellë në komunikim zhvillimi i teknologjisë. Të kryejë matje të ndryshme duke përdorur instrumente matës dhe të krahasojë rezultatet. Të shkruajë adresën e kërkuar elektronike dhe të dërgojë email.
<b>Titulli i mësimit</b>		<b>Objektiva për çdo orë mësimi Nxënësi/ja duhet:</b>
1	4.1 Kompjuterat, vend pune dhe informimi.	Të dallojë mënyra të ndryshme komunikimi. Të njohë pajisjet bazë kompjuterike.
2	4.2 Komunikimi, pajisje dhe teknologji të përparuara.	Të dallojë pajisjet kryesore të komunikimit. Të njohë rrjetin mbarë botëror informativ.
3, 4	4.3, 4 Punë praktike.	Të masë objekte të ndryshme me mjete matëse si vizore, kalibër etj. Të kryejë ushtrime praktike në laborator ose në një qendër internet.

Në këtë plan mësimesor janë të planifikuara 3 orë të lira dhe 2 orë ekskursion mësimesor.



